



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 maj 2012
Nr. ref.: RK238/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI66/11

Parashtruesi

Astrit Shabani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pn-Kr 56/2006, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 52/2004 dhe
Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 94/01**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Astrit Shabani nga Mramori, Komuna e Prishtinës. Parashtruesi është duke vuajtur dënimin me burgim në burgun e Dubravës, Istog.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi pohon, pa precizuar ndonjë dispozitë të Kushtetutës, se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë në saxe të dënimit të bazuar në prova që nuk ekzistojnë dhe në prova të falsifikuara (Neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Parashtruesi gjithashtu pohon, pa specifikuar ndonjë dispozitë të Kushtetutës se dënimi i tij shkel parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale (Neni 33 i Kushtetutës).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullin 56(2) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Më 16 maj 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
5. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova për Gjyqtare Raportuese dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Dr. Altay Suroy, dhe Dr. Iliriana Islami.
6. Më 20 mars 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

7. Më 14 gusht 2003 Gjykata e Qarkut në Prishtinë në Aktgjykimin P. nr. 94/01 gjeti parashtruesin fajtor për vrasje sipas nenit 30 paragrafi 2 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të RFJ të zbatuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24. Parashtruesi ishte dënuar me 20 vjet burg.
8. Parashtruesi parashtroi ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut brenda afatit ligjor për arsyet në vijim: shkelje esenciale të Ligjit të Procedurës Penale, vendosjen e gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe shqiptimin e dënimit në mënyrë të gabuar. Parashtruesi kërkoi që Gjykata Supreme të anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe të kthejë rastin në gjykatë më të ultë për rigjykim ose të shfajësojë dhe të lirojë parashtruesin, ose t'i shqiptohet një dënim i zvogëluar.
9. Më 2 gusht 2005 Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës rekomandoi që Gjykata Supreme të ndryshojë dispozitivin e aktgjykimit në mënyrë që të reflektojë zbatueshmërinë e rregullores së UNMIK-ut 2000/59 dhe të refuzojë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 21 nëntor 2005 Gjykata Supreme në Aktgjykimin Ap. 52/2004 pjesërisht miratoi ankesën e parashtruesit dhe ndryshoi dënimin e tij me 18 vjet burg. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të ankesës së Parashtruesit.
11. Më 6 prill 2006 parashtruesi dorëzoi një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. 52/2004 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 94/01, duke pretenduar shkeljen e rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59 dhe Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

12. Më 7 nëntor 2006 Gjykata Supreme në Aktgjykimin Pn-Kr 56/2006 hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.
13. Në kërkesën e tij parashtruesi thekson se ka parashtruar kërkesa në Gjykatën Supreme në datat në vijim: më 10 qershor 2009, më 31 korrik 2009 dhe më 3 shtator 2009. Sidoqoftë, kopjet e këtyre kërkesave nuk janë përfshirë në kërkesë/parashtresë. Gjithashtu në kërkesë nuk ka diçka që do të dëshmonte se këto kërkesa janë të bazuara në mjet të duhur juridik në dispozicion të parashtruesit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren se vendimi origjinal i Gjykatës Supreme ka datën 21 Nëntor 2005 dhe kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ishte refuzuar nga Gjykata Supreme më 7 nëntor 2006, ndërkaq kërkesa ishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese më 16 maj 2011. Kjo nënkupton se kërkesa ka të bëjë me ngjarjet para 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi. Nga kjo del se kërkesa është e paafatshme, dhe nuk është në përputhje “*ratione temporis*” me dispozitat e Kushtetutës dhe me Ligjin (shih Aktvendimi për papranueshmërinë të Gjykatës Kushtetuese, **rasti KI 25/09** Shfaqet Haxhiu kundër Organizatës së Punëtorëve të “Industriës së akumulatorëve”, të 21 qershorit 2010, dhe Bleçic kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i KEDNJ i 29 korrikut 2004).
15. Veç tjerash, Rregulli 36 (3) (h) i Rregullores së Punës parasheh se “një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur” “kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën”. Prandaj Gjykata konsideron se kërkesa është e paafatshme “*ratione temporis*”.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, rregullin 56(2) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, Gjykata Kushtetuese:

VENDOSI

- I. Njëzëri, TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Me shumicë të konkludojë se arsyetimi për papranueshmëri nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën;
- III. Ky vendim do t’u komunikohet parashtruesit; dhe
- IV. Ky vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë;

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

